



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr._____, datë_____

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 933, DATË 29.12.2014, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS
ORGANIZATIVE TË QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25, të ligjit nr. 147/2014, datë 30.10.2014, “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, me propozimin e Minisit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin Nr.933, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1 ndryshohet fjalia me këtë përmbajtje:

Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë. Organika e QKUM-së është sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Numri i punonjësve të QKUM-së është, gjithsej, 253 veta”.

2. Lidhja 1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Pika 3 ndryshohet dhe bëhet:

a) “Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) ofron shërbim, komandim, kontroll dhe koordinim të shërbimit kombëtar të urgjencës mjekësore.

Pjesë e QKUM-së janë Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore dhe **Njësia e Urgjencës** Mjekësore Paraspitalore të Tiranës.

QKUM koordinon dhe mbulon me personel mjekësor Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopter, Njësinë e Urgjencës Mjekësore Paraspitalore të Tiranës, Njësinë e Koordinimit dhe eventet madhore në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Njësia e Urgjencës Mjekësore Paraspitalore të Tiranës është pjesë e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore dhe numri i punonjësve të saj pasqyrohet në strukturën organizative të QKUM-së, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Asetet e Njesisë së Urgjencës Mjekësore Paraspitalore të Spitaleve Universitare të Tiranës (SUT, QSUT, SUSHN) kalojnë në inventar të QKUM-së.”

c) Pas pikës 3/1 shtohet pika 3/2 me këtë përmbajtje:

“3/2. QKUM bën trajnimin e personelit shëndetësor në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të urgjencës mjekësore (protokollet, pajisjet mjekësore, uniformat).

QKUM bën trajnimin e personelit joshëndetësor (personel ndihmës, mbështetës, dhënës i ndihmës së parë etj) në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, publik dhe privat, institucione të ndryshme publike dhe private.

4. Pika 4 ndryshohet dhe bëhet:

a) “Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore ka për detyrë bashkërendimin e komunikimit të gjithë sistemit të komandë-kontrollit të urgjencave mjekësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.”

b) Pas pikës 4/1 ndryshohet dhe bëhet :

“Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore dhe Njësia e Urgjencës Mjekësore Paraspitalore janë operative 24 orë, për 7 ditë të javës, dhe koordinohen nga përgjegjësit e turneve, të cilët janë mjekë të këtyre njësive.”

c) Pas pikës 4/1 shtohet pika 4/2 me këtë përmbajtje:

“4/2. Personeli mjekësor i QKUM, Njesisë së Koordinimit të Urgjencave Mjekësore, Njesisë së Urgjencës Mjekësore Paraspitalore dhe Njesisë së Transportit Mjekësor me Helikopter shërben me rotacion në të gjitha këto njësi, për mbulimin e shërbimit.

5. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

a) Pas gërmes e), shtohet gërma ë), me këtë përmbajtje:

“ë) Personeli mjekësor (mjekë dhe infermierë) i QKUM, Njesisë së Koordinimit të Urgjencave Mjekësore, Njesisë së Urgjencës Mjekësore Paraspitalore dhe Njesisë së Transportit Mjekësor me Helikopter për mbulimin e shërbimit të urgjencave dhe kualifikimin e personelit zhvillon

aktivitetin e tij pranë Urgjencave Spitalore (universitare, rajonale dhe bashkiake), Qendrave Shëndetësore, institucioneve private etj, në rast marrëveshjesh të QKUM-së me këto institucione.”

b) Në pikën 7 pas gërmës ë), shtohet gërma f), me këtë përmbajtje:

“f) QKUM lidh marrëveshje me Spitalet (universitare, rajonale dhe bashkiake), Qendrat Shëndetësore, institucione private etj, për mbulimin e shërbimit me personel të vetin ose të Institucioneve të sipërpërmendura. Personeli mjekësor mbulon shërbimin brenda orarit të punës dhe me roje. Pagesa kryhet sipas strukturës së pagave dhe sistemit me roje.”

c) Në pikën 7 pas gërmës f), shtohet gërma g), me këtë përmbajtje:

“g) Të ardhurat dytësore të krijuara nga QKUM, nga ofrimi i shërbimeve të ndryshme dhe trajnimet, kalojnë në buxhetin e QKUM-së.”

d) Në pikën 7 pas gërmës g), shtohet gërma gj), me këtë përmbajtje

“gj) Personeli shëndetësor dhe joshëndetësor që kryen aktivitetin në Shërbimin e Urgjencës Mjekësore Paraspitalore publike dhe private çertifikohet nga QKUM. Personeli joshëndetësor (personel ndihmës, mbështetës, dhënës i ndihmës së parë etj) që kryen aktivitetin në shërbimin shëndetësor, publik dhe privat çertifikohet nga QKUM.”

Strukturat e urgjencave mjekësore paraspitalore të tre spitaleve universitare kalojnë në administrim te Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, së bashku me asetet dhe burimet financiare të planifikuara për këtë shërbim në buxhetin e vitit 2021.

Ky vendim hyn në fuqi në 1 Janar 2021.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Lidhja 1

STRUKTURA E QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE	
DREJTORI I PËRGJITHSHËM	1
Specialist i Lartë Sekretar	1
Drejtoria e Financës, Investimeve dhe Buxhetit	(23)
Drejtori	1
Spektori i Financës/Buxhetit/Investimeve	(6)
Përgjegjës sektori	1
Specialistë finance	3
Llogaritar i mesëm	1
Specialist investimesh (inxhinier)	1
Spektori i Shërbimeve Mbështetëse	(10)
Përgjegjës sektori	1
Specialist i BNJ-së	1
Arkivist	1
Sanitarë	5
Magaznier	2
Spektori teknik dhe logjistik	(3)
Përgjegjës sektori (inxhinier)	1
Teknik i mesëm (specialitete të ndryshme)	2
Spektori juridik	(3)
Përgjegjës sektori	1
Specialistë jurist	1
Specialist prokurimi	1
Drejtoria e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore	(219)
Drejtor (mjek)	1
Spektori i Njësisë së Koordinimit të Urgjencave Mjekësore	(76)
Përgjegjës sektori (mjek)	1
Kryeinfermier urgjence	1
Mjeke urgjence	29
Infermierë urgjence	45

Sektori i Njesisë se Urgjencës Mjekësore Paraspitalore	(139)
Përgjegjës sektori (mjek)	1
Kryeinfermier urgjence paraspitalore	1
Mjekë urgjence	30
Infermierë urgjence	44
Shoferë ambulance	63
Sektori i Trajnimeve, Certifikimeve dhe Akreditimit	(3)
Përgjegjës Sektori (shkenca mjekësore)	1
Specialistë të lartë (shkenca mjekësore)	2
Drejtoria e Statiskës, Regjistrit të Urgjencës, Parandalimit dhe Komunikimit	(9)
Drejtor	1
Sektori i Statistikës dhe Regjistrit të Urgjencës	(4)
Përgjegjës Sektori (shkenca mjekësore)	1
Specialistë të lartë (shkenca mjekësore)	2
Operatorë	1
Sektori i Parandalimit, Kontrollit të Cilësisë, Edukimit dhe Komunikimit	(4)
Përgjegjës Sektori	1
Specialistë të lartë (shkenca mjekësore)	2
Specialistë të lartë (shkenca sociale)	1
Numri total	253